

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                             |
|---------|---------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Destabiliteti, kur interesi marton Ramën me Berishën                                        |
| ADRESA  | https://zgjohushqiptar.com/2026/02/destabiliteti-kur-interesi-marton-ramen-me-berishen.html |
| BURIMI  | zgjohushqiptar.info                                                                         |
| GJENDJA | online                                                                                      |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                          |
|-----------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 6 shtator 2026, 15:56:25 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 12 shkurt 2026, 16:21:14 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 9bb7280f5025252a42ec4d08ec9af007f1bca70b890b41727917344e17daa19c |
| TEKSTI     | 0751839961e7c6a193207f2cb8b288519c4ea18b70f54ab40be60949844b0f54 |
| PAMJA      | 9ab05cd3e35ba5594c8e10b287a77aeba514431cfd00a93ad0e28bc1f4c95539 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                    |
|---------------|--------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 8d2cf8ee86ad506fc13b34049720b85953aec1cdb6b7a9ee2408ef8128601bf5   |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                  |
| RRËNJA MERKLE | bb4e79b3ec69077edf87697d0c7be1f8024ce2653cdf443ef98b2b2b16c0a234   |
| ANKORUAR      | Polygon PoS · bllok 47169057                                       |
| TRANSAKSIONI  | 0xc53d1d83eb5113e27101883e7ec1c599aedef807da486e98a6185fca192c6367 |
| IPFS          | QmVM2yPqkGdMM4oCMYr6dnZ3RqmeCHegWHRJZJGnzkgCiv                     |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8d2cf8ee86ad506fc13b34049720b85953aec1cdb6b7a9ee2408ef8128601bf5>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



## Destabiliteti, kur interesi marton Ramën me Berishën

Ada Goxha Last Updated: 12/02/26 - 17:02

Nga Lorenc Vangjeli

Duket si paradoks. Ngjan si pamundësi. Teorikisht është në kufijtë e të pabesueshmes. Por njëkohësisht, është edhe një mundësi logjike, që për shkak të rrethanave dhe interesave krejtësisht të ndryshme, dy ekstremet politike në vend, Rama dhe Berisha, t'i bashkojë interesi i përbashkët për "pak lojë" me destabilitet të vendit.

I dyti, që është pala e parë e interesuar në këtë ekuacion logjik, natyrisht është Berisha. Mbas dy protestave me regji e skenografi të përcaktuar, lideri i opozitës kërkon që vendi të rrëshqasë në destabilitet. Ky do të ishte momenti ideal për rifaktorizimin e opozitës në lojën politike të përditshmërisë së vendit. Sepse në përpjekjet për rinormalizimin e situatës, opozita do të ishte pala bashkëbiseduese në negociatat për zgjidhje. Ku padyshim, sipas traditës qesharake të Shqipërisë, faktori ndërkombëtar do të ishte gjithashtu arbitri i ftuar në tryezë. Kjo gjë nuk ka ndodhur më në Shqipëri prej pothuaj një dekade. Për opozitën do të ishte pozitiv çdo ndryshim sado modest nga Status Quo-ja humbëse i Status Quo-së aktuale. E pafuqishme në Kuvend, me diferencë të madhe elektorale nga PS, e paaftë të përfitojë politikisht nga spirallja e andrallave penale ku ka hyrë maxhoranca, e frustruar nga dilemat për qëndrimin e saj ndaj SPAK-ut dhe ende në përpjekje për të çarë izolimin e vjetër ndërkombëtar, kryesisht non gratat amerikane dhe britanike, për opozitën kjo do të ishte zgjidhja ideale. Ajo është kryqëzuar me shpatulla pas murit dhe nuk ka mundësi të bëjë më asnjë hap pas edhe kur duket se hedh ndonjë hap të ndrojtur bashkëpunimi me pozitën. Kjo është një nga mënyrat për të shpjeguar dhunën e orkestruar dhe skenike në fundin e dy protestave të njëpasnjëshme të këtij dimri. Kjo taktikë, përveçse një injeksion adrenaline për militantët, është tentativë e maskuar keq për të tërhequr maxhorancën në një spirale dhune si kundërpërgjigje. Protesta e tretë e 20 shkurtit parashihet të kulmojë dhe më tej në të njëjtën mënyrë apo edhe me përshkallëzimin e dhunës dhe qëndresës në shesh. Për të shkuar kështu drejt ëndrrës dhe maktit të Berishës për të patur edhe ai 21 janarin e tij. Edhe Rama, edhe Berisha e dinë që historia e këtyre 15 viteve të fundit në Shqipëri, do të ishte krejt ndryshe pa atë masakër kriminale dhe të pakuptimtë në bulevard. Ndaj nëse njëri kërkon rikthimin në Tiranë të fantazmës së asaj të Premteje të Zezë, por tashmë nga pozitat e viktimës, tjetri di se nuk duhet të zërë kurrë vendin e agresorit të dikurshëm.

I pari, që është pala e dytë e interesuar në këtë ekuacion logjik është Rama. Mbas një fitoreje në kufijtë e të pamundurës dhe të një përmase epike, normaliteti dhe rrjedha logjike e ngjarjeve, për paradoks duket se nuk është në interes të kryeministrit. Ndryshe nga sa ishte menduar dhe pikërisht për shkak të thellësisë së triumfit të tij vetjak në zgjedhjet e vjetshme, Rama nuk realizoi planin e tij të katarsisit të kampit të tij. Rinovimi pothuaj tërësor i grupit parlamentar me njerëz të rinj pa ngarkesa dosjesh penale në shpinë, nuk u shoqërua me të njëjtën skemë edhe në qeveri. Qeveria Rama 4 është identike me Rama 3, edhe pse kryeministri e dinte mirë serinë e halleve me SPAK që pritej të kishin, siç po ndodh,

nje pjese dometheniese e kaqmeut te tij. Zevendesja e tij daliku eshte pika me dometheniese e mosveprimit te tij atehere kur mund te hiqte dorë dje nga çfarë nuk ka sot në dorë ta mbajë. Në vend të saj, ai hapi disa fronte beteje pa ndonjë domethënie të veçantë. Turi në bashkitë e vendit, aksioni për prishjet e tendave dhe ndërtimeve pa leje, edhe nëse ishin të nevojshme, nuk kishin asnjë urgjencë. Rama përdori fasho kirurgjikale në vend të mjekimit për plagët e ardhshme që po hapen në trupin e maxhorancës së tij. I shkeli syrin pasojave duke përqeshur shkakun. Edhe kursi i përplasjes me drejtësinë, më së paku, është i vonuar dhe me shumë një defekt i mosadresimit në kohë të problemit, sesa një tentativë për zgjidhjen e tij. Në këtë kuptim, një destabilitet i mundshëm dhe i kontrolluar i situatës së vendit, do t'i jepte atij mundësinë për të marrë spaletat e zjarrfikësit për shuarjen e saj. Do t'i jepte mundësi të stigmatizonte dhe njëherë kundërshtarin si të dhunshëm, si një bela që i ka rënë për pjesë dhe një jorgan puplash për të mbuluar hallet e ditës. Në një arbitrim të mundshëm ndërkombëtar, ai do të hynte me shumë karta fituese në dorë, por kryesisht jo për shkak të fuqisë së tij të vënë në diskutim, por të pafuqisë së kundërshtarit që pranohet pa asnjë diskutim.

Edhe pse duket si paradoks i pamundur dhe në kufijtë e të pabesueshmes kjo "martesë" interesi, fatmirësisht ka një vijë të kuqe që i ndan dy armiqtë e betuar. Dy njerëzit më të fuqishëm të Republikës së Zeqilandit i ndan fatmirësisht një bindje absolute: Mbi demonstruesit me molotovë mund të hidhet gaz lotësjellës, ujë me presion apo dhe mund t'u hedhë valle në shpinë shkopi i gomës, por nga kryeministria nuk do të qëllohet kurrë me fishekë luftarakë kundër tyre. Ndryshe, hataja bëhet mbret dhe Shqipëria, një mbreteri e deshperuar!


Shpërndaje



Facebook



X



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.